

UDHËZIM
Nr. 14, datë 13.5.2015

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1, dhe nenit 50, pika 4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 49.3, shtohet pika 49.4, me përmbajtjen e mëposhtme:

“49.4 Në rastin e shitjes së dekoderave, në faturën tatimore, shkruhet numri personal i identifikimit të individit blerës të dekoderit. Numri personal i identifikimit të blerësit, person i patatueshëm, vendoset në vendin e përcaktuar në faturë, për vendosjen e NIUS-it, për rastet kur blerës është një person i tatueshëm.”.

2. Pas pikës 50.9, shtohet pika 50.10, me përmbajtjen e mëposhtme:

“50.10 Në rastin e shitjes së dekoderave, në faturën tatimore me TVSH, shkruhet numri personal i identifikimit të individit blerës të dekoderit. Numri personal i identifikimit të blerësit, person i patatueshëm, vendoset në vendin e përcaktuar në faturë, për vendosjen e NIUS-it, për rastet kur blerës është një person i tatueshëm.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
SHKËLQIM CANI